

FILLET E LETËRSISË SHQIPE NË LUGINË TË PRESHEVËS**Shefat ADEMI¹**¹*Primary Schol "Zenel Hajdini" - Raince, Preshevo***Corresponding author e-mail: shefatademi1@gmail.com***Përmbledhje**

Rruga, për krijimin e një letërsie të barabartë me të gjithë shqiptarët kudo ku jetonin dhe vepronin nuk u ndal asnjëherë sado që ishte tepër e vështirë. E mu për këtë Lugina e Preshevës me gjithë përpjekjet për të jetuar me ëndrrën e bashkimit kombëtar nuk rreshti asnjëherë. Edhe pse që nga sundimi i Perandorisë Osmane, e cila ishte e përfshirë në Vilajetin e Kosovës, ajo e kultivoi me dashuri letërsinë pa marrë parasysh rreziqet me të cilën i kanoseshin asaj. U desht shumë vite më vonë, që kjo letërsi të merrte tatëpjetën, pikërisht me daljen në sipërfaqe të shumë ngjarjeve historike të cilën e preokuponin atë.

Letërsia shqipe, që nga fillimet e para pas Luftës së Dytë Botërore, evoluoi në mënyra të ndryshme me faktin se u trajtuan shumë tema lidhur, me preokupimin kryesor se si do të dalin në dritë shumë vepra që do ta bëjnë një letërsi të quhet tamam letërsi e mirëfilltë shqipe. Hapat e parë, për t'u barazuar me letërsitë e trojeve shqiptare edhe Lugina e Preshevës pati dëshirën e flaktë që t'i bashkangjitet kësaj nisme, për t'u dukur një nuse e re me një mision të ri. Ajo pati vështirësi të shumëta, sepse në të ndikuan shumë faktorë që patën dëshirën e flaktë ta zhbëjnë fund e krye atë.

I qëndroi ballë shumë sulmeve barbare, që kishin caktuar njerëz të huaj që një letërsi e krijuar me motive të dhembjes të mos pasqyrohet aty ku vlera e demokracisë ishte gjysmake, dhe me pretekstin se një letërsi e krijuar me motive të tilla prishte rendin "kushtetues dhe demokratik" të një shteti që punonte kundër gjithçkaje që ishte moderne. Kur themelet e ish-Federatës Jugosllave, prej viteve 90-ta, dita ditës po lëkundeshin dhe shumica e poetëve dhe shkrimtarëve kishin përjetuar t'merrin e cenzurës dhe burokracisë e që kishin lindur në Kosovë, si Ali Podrimja, Hivzi Sulejmani, Esad Mekuli, Rexhep Qosja, Sinan Hasani, kur Lugina e Preshevës që nga viti 1959 e tutje, de fakto ishte pjesë e saj ku këta krijues kishin përjetuar tmerret e një shteti, që kishte ndaluar letërsitë e tyre që kishin të bëjnë me gjenezën, përparimin dhe bashkimin e shqiptarëve në një shtet të vetëm.

E pikërisht nismat e këtyre shkrimtarëve, shkrepën idetë edhe në Luginë të Preshevës se duhet patjetër të vazhdoj rruga e këtyre shkrimtarëve, që sot e kësaj e dite kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në letërsinë shqipe. Presheva, e përjetoi rëndë të ardhmen e vet sepse që nga Kongresi i Berlinit (1878), duke përfshirë Lidhjen e Prizrenit (1878), e deri te lufta e fundit e viteve 98-99, e gjeti të ndarë nga trangu shqiptarë. Asaj i'u padrejtësi e madhe sepse mbeti në sundimin serb, e cila në masë të madhe filloi të zbrazet dhe mbeti një njollë e pashlyer që sot e kësaj dite pikon lot, se pse historia u tregua e padrejtë.

Dhe pikërisht, këto motive zunë vendin kryesor, në plejadën e shkrimtarëve preshevarë, që do të krijoheshin menjëherë pët t'i dhënë letërsisë shqipe një frymë që do të shihej gjithkund anekënd trojeve shqiptare. Formimi i një elite shkrimtarësh, që njëkohësisht ishin edhe duajenë të mëdhenj të letërsisë tashmë po hapnin siparin më të ç'mueshëm të letërsisë shqipe, që u rreshtuan krahë për krahë me poetët dhe prozatorët të më të mëdhenj të kombit shqiptar. Aty krijimet e para të gdhendura në prozë e poezi, do t'i nisin, *Bilall Maliqi, Arsim Halili, Sahadete Presheva, Qerim Arifi, Demush Berisha, Nehat Ramizi, Ismet Bajrami, Alixhemal Salihu, Mexhit Mehmeti, Fehime Salihu, Avni Shaqiri, Rrahman Hyseni, Rexhep Abazi, Halim Hasani, dhe një grup poetësh të ri/e si Marigonë Fejzullahu, Linda Agushi, Qëndresa Jakupi, Esra Aqifi, Lirona Zuka*, do të arrinë të krijojnë një letërsi që vërtetë ja vlenë të studiohet.

Kësaj nisme do t'i paraprijë edhe themelimi i Revistës së vetme letrare "QËNDRESA" që si qëllim ka botimin e zhanreve letrare, e krijuesve letrarë nga tri komunat shqiptare, që jetojnë në Kosovën Lindore. Mjerisht edhe sot edhe pse të ndarë në troje, letërsia e krijuar në Luginë asnjëherë nuk e humb primatin e të qenurit e barabartë me atë të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, e gjetiu.

Krijimet e para letrare të autorëve Preshevarë

Fillimet e para e letrare si asnjëherë më parë nxorën në sipërfaqe autorët më të mirë duke filluar nga poetët më të mirë që tashmë nuk gjenden në mesin tonë Sahadete Presheva, Qerim Arifi, Fehime Salihu, Demush Berisha, të cilët nxorën veprat më të mira në poezi e prozë. *Sahadete Presheva* u paraqit në skenën letrare pikërisht kur atëherë thuajse letërsia kishte pushuar së vepruari, dhe po jepte frymën e fundit. Ajo me veprat e saja letrare, ngjizi të rinjtë që të merren me këtë zhanër sepse njeriu në letërsi nga e pamunshmja mund të afrohet te e mundshmja, prandaj ajo u cilësua si poetesha e parë nga gjitha viset shqiptare në Jugosllavi, që hyri në letërsi me bujë të madhe.

Tek veprat e e saj, "*Sahadete Presheva, Simbol i Femrës Shqiptare*", "*Kërkoj kohë të qetë*" paraqesin vrullet dhe fatkeqësitë që në të cilën ka kaluar ky popull. Mjerisht poetëve, sikur u mungon koha dhe kur ata shkrujnë si një Orfe, që e nesërmja të frymojë më lirshëm sesa e sotmja. Poetesha e parë e trojeve shqiptare në Jugosllavi, si Sahadeta i'u deshtë doemos këtij trangu që ishte i vuajtur dhe lëngonte vrer nga një okupator që nuk e lente vendin të përparojë. Prandaj, Luginës sot e kësaj dite i duhen poetesha sikur ishte shpirtbardhësia e Sahdetes.

Gjatë sundimit të egër, të Rankoviqit e këndeje krijuesit letrarë nuk e patën aspak të lehtë të arrinë majat e suksesit, sepse politika diskriminuese nuk lente aspak hapësirë që letërsia të frymonte lirshëm. U desh kohë e gjatë që krijuesit të vazhdonin të krijojnë lirshëm, në një hapësirë si Luginë e Preshevës që cenzurohej vazhdimisht. Rrugën e letërsisë e vazhdoi edhe poeti tjetër i ndjerë, *Qerim Arifi* i cili mu në mes të katrahurave në të clën ndodhej populli shqiptarë, ai vazhdoi të shkruaj duke nxjerrë veprat më të mira letrare.

Veprat letrare të Qerimi-t, si "*Kujtime*" "*Nokturno*" - "*Mbyllur në urnë*" - "*Fatamorganë*" "*Rekuiem për kalanë*" përmbledhin shpirtin krijues, që tashmë ai kishte krijuar. Ja seç shkruan ai kur i drejtohet lexuesit:

*Më fal e lexues nderuar, unë Qerim Arifi,
Nuk jam i mbyllur në urnë,
në gjendem në fytin e saj,
as nuk mund të hyj as nuk mund të dal*

Shpirti krijues i Qerim Arifit, nuk duron padrejtësi, prandaj ai dëshiron të jetë i lirë, në vendin e tij, sepse poetët gjithmonë vine me vonesë, por thonë gjëra që vlejnë më shumë se një jetë. Në veprën "Lartësia e një jete Antologji poetike për poetin Qerim Arifi" e studiuesit Luan Maloku, redaktorja e këtij libri Prof. dr. Zejnepe Alili Rexhepi në Parathënien e tij shkruan se: "Poezia dhe shkrimet publicistike të Qerim Arifit, botuar përmes "Zëri i rinisë", do të mbeten postulate autoriale me kodin e identifikimit unik për një autor, për një vepër sigurisht me vlera

universal megjithëse pika e dhimbjes është forma që veprën e përafrohet me kohën e jetuar me artin". Jo rastësisht, poetë si Qerim Arifi, lindin herët, krijojnë, dhe në fund lavdia qëndron gjithmonë në supet e tyre, për t'a bërë letërsinë jetë, e jetën letërsi.

Karvani i letërsisë, u veçua edhe me një poete femër e cila mbushi boshllëkun që kishte lënë poetja Sahadete Presheva. E tillë, me shpirtin e saj tejet human e të veçantë ishte edhe Fehime Selimi e cila shkroi veprat poetike më të kulluara që sot, para lexuesve ajo paraqitet me librat e botuara si: "Fjala ime ka etje", " Dita e trembëdhjetë" "Kohë me shi" në të cilën pasqyrohen malli dhe dhembjet në të cilën po kalonte populli shqiptar i zhgarravitur në prapësitë e kohës. Në poezinë : "Ëndërrim" në një varg të saj ajo shkruan, për kohën e humbur në të cilën popullin shqiptar e kishte kapluar errësira, dhe vështirë të dilte nga qorrrokaku ku ishte futur prandaj ajo shprehet:

*Nuk mbeti asgjë nga koha
Përtej vetmisë
Asgjë pos ditës
Pos netëve çuditërisht të bardha
Çdogjë e mbështolli
Mallkimi⁴⁸⁰*

E tillë pra ishte Fehimeja sepse, me shkrimet poetike të saj ajo ngjalli një shpresë se fermra në letërsi mund të kapërcej nga e pamundura në reale. Ajo mbeti gjithmonë e tillë, sepse sot ne kujtojmë me pietet krijimtarinë letrare në të cilën e ngriti lart letërsinë e femrës në Luginë madje edhe në krejt trojet shqiptar. Poeti tjetër, i cili më nuk gjendet në mesin tonë por meriton respekt të veçantë dhe që për së gjalli u quajt Migjeni preshevar sepse shkroi me një frymë jashtzakonisht të bukur, që edhe luginasit e donin shumë, e ai është *Demush Berisha*.

Saherë që rrinim bashkë, ishte një njeri i urtë, një atdhdashës i madh, një shkrimtar e poet i pasionuar pas letërsisë për fëmijë që e deshi deri në frymën e fundit. Baca Demush, kështu e thërrisnim ne të rinjtë pati një opus krijues shumë të madh. Ai pas vetes la një numër të konsideruar veprash në të cilën spikat dashuria, dhe vullneti për një të ardhme të mirë. Sikur, çdo poet e shkrimtar që me mburrje flet për gjenezën e tij, edhe *Demush Berisha* i këndon me pietet Malësisë së Karadakut të Preshevës prej nga edhe e kishte prejardhjen.

Ai pas vetes la këto vepra: " *Fluturim të mabrë*, " *Iliriku*", *Prishtin*, " *Ylber me ngjyra*", " *Motrat binjake*" " *Libreza me pesa*" " *Mik për një fyel magjik*" " *Lumi s'ka moshë*" dhe " *Karadaku i Preshevës, mburrje dhe krenari*". Vepra e Demush Berishës, mbeti testament sidomos i brezave të rinjë, se rruga e letërsisë gjithmonë është e hapur për të gjitha ata që e duan dhe ndjejnë shpirtërisht, e pafundësisht. Etapa e shkrimtarëve të parë preshevarë hapi shtigje të reja sepse të tjerët që do të vinin, tashmë e kishin modelin sesi duhet, që poezia të arrijë kulminacionin kur para vetes ka shumë personalitete që dhanë kontribut të çmuar tek populli preshevarë.

Brezi i poetëve bashkëkohorë

Periudha, në të cilën letërsia në Luginë nuk e humbi aspak primatin si vazhduese e denjtë ishte ajo pas luftës së fundit, e cila nxori në sipërfaqe një brez të ri të poetëve që trasuan rrugën e atyre të parëve. Nuk ishte e lehtë sepse vendi, pas ngjarjeve të viteve 90-ta, kishte dalur nga gërmadhat e një lufte të pabarabartë që pushtuesi sllav, kishte lënë në kujtesën e gjithsecilit. Krijuesit, që sot vazhdojnë ta kultivojnë poezinë në vija të veçanta për momentin, vlenë të theksohet ajo e Bilall Maliqit, Arsim Halilit, Nehat Ramizit, Rrahman Hysenit. Po e nisi me autorin e një morive veprash siç është *Bilall Maliqi*. Ai i përket, poetëve bashkëkohorë ku me letërsisë e tij veçanërisht poezinë, e ka ngritur në piadestale duke i dhënë dimensione të rëndësishme.

⁴⁸⁰ Revista letrare, "Qëndresa" 10, Fehime Selimi, Preshevë, 2020, f, 24.

Bilalli karakterizohet me një mori veprash të botuara, ku epiqendra e tij mbetet poezia si për të rritur ashtu edhe për të rinjë. Shkruan me një mision, e ai është që nëpërmes saj të arrijë të senzibilizoj masën e gjërë, veçmas atë të ngjarjeve aktuale ditore. Ka botuar mbi tridhjetë e pesë e vepra, ku shquhet sidomos edhe në mjeshtrinë e prozës dhe atë të aforizmave. Ja disa vepra të tij: "*Gëzim dhe drojë*", "*Lutje të lagura*", "*Hëna flet me lule*", "*I kthehem ëndrrës*", "*Pikojnë fjalët*", "*Shkreptimë dashurie*", "*Kodra e luleve*", "*Pikëpyetje kohës*". Ai sot, përfaqëson kudo që shkon poezinë, traditën dhe mbi të gjitha kulturën preshevare.

Për Bilallin, dhanë mendime shumë studiues ku një ndër ta është edhe Prof. dr. Fatmir Sulejmani ku mes tjerash shkruan: Parë nga ky kënd, Bilall Maliqi është zgjatim i prometejëve të Rilindjes shqiptare, që flijuan gjithçka për çështjen e ruajtjes së njësisë së gjuhës, gjakut dhe vatanit.⁴⁸¹ Pohimi i prof. Fatmirit, jep të kuptojmë se Bilalli është një ndër njerëzit më meritore që me gjitha mundësitë lufton që kombi shqiptar asnjëherë mos të shkoj drejt zhbërjes, po të eci në rrugë e mbarë ashtu siç ishin edhe Rilindësit.

Emri tjetër që meriton të përmendet në këtë studim, është edhe poeti *Arsim Halili*. Ai i përket një plejade shkrimtarësh të cilët me ngulm e kultivojnë poezinë. Meqë, atë e kam mik të çmuar, tash e sa vite lirisht mund të them se ai krijon një poezi të çliruar nga paradokset e shumëta me një ndjeshmëri të lart, dhe mbi të gjitha ai poezinë e ka zanat që e kultivon tash e sa vite. Shpirti i tij krijues ka dëshmuar se, poezia edhe pse është zanat goxha i rëndë, ai gjithmonë ka gjetur shtigje të arrijë cakun ku ai dëshiron. Vargjet e Arsimit kanë një specifikë të veçantë sepse ato janë pasthirma të dhembjes, të cilat ai i ndjen me shpirt, dhe gjitha emocionet ai i derdh në vargun e poezisë. Cilësohet si një shkrimtar, që ka hapur shtigje të reja edhe në shkrimin e novelave më të mira që ai mund të krijon.

Si një poet dhe pedagog, i pashoq ai ka arritur të botoj këto vepra poetike: "*Heshnje e shprishur*", "*Ndal! Stacioni i dashurisë*", "*Gjurmët e qëndresës*", "*Shtigjeve të artit*", "*Mëkatar mos eja*", "*Portretizime eseistike*", "*Sprova eseistike*". Poezia është një armë e mbushur me të nesërme thoshte poeti *Gabriel Selaja*, prandaj edhe poezia e *Arsim Halilit* është një armë që saherë e shkrep në popull krijon vetëdije. Letërsia në Luginë të Preshevës, u shtri në përmasa më të gjera sepse në skenë dolën edhe shkrimtarë e poetë të njëpasnjëshëm që nxorën veprat më sublime që unifikojnë popullin në të gjitha pikëpamjet kombëtare. Poetët, e radhës si *Nehat Ramizi*, i cili i ka dhënë kolorit mjaft të madh poezisë shqipe, unë e çmoj shumë si mik, dhe atdhedashës i pashoq.

Por nuk mbaron me kaq, sepse Presheva përveç poezisë dhe prozës në mesin e vet posedon edhe njerëz që i kanë dhënë konotacion mjaft të rëndësishëm edhe tarshëgimisë kulturore është edhe *Xhemaledin Salihu*, i cili tash e sa vite merret me tashëgiminë kulturore preshevare shkruan e boton vazhdimisht tituj librash nga më të ndryshëm. Ai ka botuar këto vepra: "*Presheva pjesë e pandarë e Lëvizjes Kombëtare nëpër shekuj*", "*Kultura shqiptare në Preshevë 1945-1995*", "*Mëhallët dhe toponimet e vendbanimeve të Komunës së Preshevës*" e shumë vepra të tjera që e bëjnë edhe më të larmishme studimin e kësaj fushe.

Edhe në Medvegje, letërsia u shtri në përmasa mjaft të gjera. Aty gjetën muzën e inspirimit shumë poetë e shkrimtar të talentuar, që meritojnë të shkruhet qoftë edhe një varg për ta, bëhet fjalë për shkrimtarin dhe poetin *Rrahman Hyseni*, *Rexhep Abazi*, dhe poetja *Lirona Zuka*. Mjerisht, sot Medvegja thuajse është boshatisur krejtësisht sepse nga padrejtësitë që atyre shqiptarëve që u bëhen atje ata tashmë jetën e tyre e vazhdojnë në Kosovë. Dhe më në fund, sot me fillimin e shekullit XXI, letërsia në trevën tonë frymon lirshëm sepse nuk e ka primatin sikur dikur të ishte e censuruar, sepse botohen, vepra të karaktereve të ndryshme, dhe falë një lirie të cilën e gëzojmë sadopak.

⁴⁸¹ Fatmir Sulejmani, Gjurmë kohe, ese, Brezi 9, Tetovë, 2019, f. 356.

Referencat

- [1]. Revista letrare, "Qëndresa" 10, Fehime Selimi, Preshevë, 2020.
- [2]. Maloku Luan, "Lartësia e një jete Antologji poetike për poetin Qerim Arifi", Prishtinë 2015.
- [3]. Sulejmani Fatmir,, " Gjurmë kohe, ese", Brezi9, Tetovë, 2019.
- [4]. Halili Arsim, "Gjurmët e Qëndresës", Dardanë, 2019.